



Planuar / Dorëzuar Primi/Pradato Received/Delivery	08-05-2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHK	4126/2023		117



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.485/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën nën shenjen A.nr.485/2023 të datës 10.03.2023, të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 08.05.2023, njëzëri mori këtë:

### V E N D I M

- I. *Refuzohet si e pabazuar* ankesa nën shenjen A.nr.485/2022 e datës 10.03.2023, e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_
- II. *Mbetet në fuqi* Vendimi me numër protokoli 66-19 i datës 10.02.2023 i Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

### A r s y e t i m

Ankuesi \_\_\_\_\_ (me tej vetëm ankuesi), më datë 10.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokoli 66-19 të datës 10.02.2023 të Komisionit Vlerësues për Lëvizje Brenda Kategorisë në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, me pretendimet ankimore sw vendimi i kundërshtuar është nxjerr me shkele te ligjit material.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Këshilli) në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 28.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa kjo e fundit më datë 05.04.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat referuar kësaj çështje juridiko-administrative.



Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër protokollit 3693 të datës 19.04.2023 ka vazhduar afatin për vendimmarrje lidhur me ankesën e ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 2565/2023 të datës 10.03.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokollit 660-19 të datës 10.02.2023; Ankesën e datës 21.11.2022; Emalin e datës 08.02.2023 të drejtuar Emalin e datës 08.02.2023 të drejtuar Emalin e datës 14.11.2022 të drejtuar Konkursin e datës 19.08.2022 për pozitën e punës " Udhëheqës i Sektorit për Siguri me Produkte"; Konkursin e datës 18.08.2022 për pozitën e punës "Inspektor i Tregut" Njoftimin e datës 06.10.2022 për kandidatin e suksesshëm për pozitën e punës "Inspektor i Tregut" Njoftimin (pa numër dhe datë); Njoftimin e datës 20./09.2022 lidhur me kandidatet që plotësojnë kushtet e konkursit për të vazhduar tutje; Emalin e datës 21.10.2022 të drejtuar Njoftimin e datës 13.02.2023 lidhur me kandidatet që kanë plotësuar kushtet e konkursit; Vendimin me numër A.nr.1001/2022 të datës 27.12.2022 të KPMSHCK; Emalin e datës 10.02.2023 të drejtuar Emalin e datës 058.0.22023 të drejtuar Emalin e datës 07.02.2023 të ZKP drejtuar Përgjigjen me numër 583-18 të datës 07.02.2023; Renditjen përfundimtare të kandidateve; Formularët e Vlerësimit të datës 30.09.2022 të anëtareve të Komisionit Vlerësues; Ankesën pa datë dhe numër të parashtruar nga ankuesi në Komisionin e Vlerësimit; Emalin e datës 21.01.2023 të drejtuar ZKp-së; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 28.03.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 05.04.2023; Njoftimin e Divizionit të Burimeve Njerëzore (pa numër dhe datë); Emalin e datës 10.10.2022 të drejtuar Emalin e datës 03.10.2022 të drejtuar Emalin e datës 06.10.2022 të drejtuar; Emalin e datës 01.11.2022 të drejtuar Emalin e datës 01.11.2022 të drejtuar; Emalin e datës 02.11.2022 të drejtuar Emalin e datës 01.11.2022 të drejtuar; Emalin e datës 01.11.2022 të drejtuar Emalin e datës 31.10.2022 të drejtuar; Emalin e datës 01.11.2022 të drejtuar Emalin e datës 01.11.2022 të drejtuar Emalin e datës 31.10.2022 të drejtuar; Emalin e datës 01.11.2022 të drejtuar Emalin e datës 01.11.2022 të drejtuar; Emalin e datës 31.10.2022 të drejtuar; Emalin e datës 02.11.2022 të drejtuar; Emalin e datës 01.11.2022 të drejtuar Emalin e datës 01.11.2022 të drejtuar; Emalin e datës 31.10.2022 të drejtuar; Emalin e datës 02.11.2022 të drejtuar; Emalin e datës 01.11.2022 të drejtuar; Emalin e datës 01.11.2022 të drejtuar; Emalin e datës 31.10.2022 të drejtuar; Emalin e datës 02.11.2022 të drejtuar; Emalin e datës 01.11.2022 të drejtuar; Emalin e datës 31.10.2022 të drejtuar; Emalin e datës 14.11.2022 të drejtuar; Emalin e datës 01.11.2022 të drejtuar; Emailin e datës 31.10.2022 të drejtuar, Aplikacionin e Ankuesit të datës 12.09.2022; Emilin e datës 19.09.2022 të drejtuar Emalin e datës 19.09.2022 të drejtuar; Emalin e datës 19.09.2022 të drejtuar Emalin e datës 19.09.2022 të drejtuar dokumentacionin e aplikim it të ankesuit: Diplomën me numër 007011



të datës 27.05.200; Diplomën universitare me numër 165 të datës 04.05.2016; Diplomën universitare me numër Nr.262 të datës 18.05.2011; Certifikatën e datës 12.10.2009; Diplomën me numër 1260310 të datës 22.12.2009 lidhur me përfundimin e kursit të gjuhës angleze; Certifikatën e datës 03.02.2014; Certifikatën nën shenjën 210 të datës 14.04.2015; Certifikatën e datës 18.12.2016; Certifikatën me Nr.30/22 lidhur me përfundim e trajnimit "Menaxhimi i Kontratave Publike dhe përgatitje specifike Teknike"; Vërtetimin e punësimit nën shenjën 6/SRR/0605/222 të lëshuar nga Drejtori i Departamentit për Operacione në Policinë e Kosovës; Vendimin me numër 0891 të datës 20.07.2010; Vendimin me numër reference 07/1-01A/7659; Letër rekomandimin e datës 05.09.2022; Memorandumimi zyrtar pa datë dhe numër të identifikuar; kopje e ID-së; Formularin e Vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 28.01.2022; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2021; Vërtetimin me numër të referencës 07/1-01SAP-P/7092; Aplikacionin e datës 07.09.2022 të kandidatit si dhe dokumentacioni percjelles; Certifikatën me numër të referencës 505-0512 të datës 03.05.2012; Diplomën e datës 09.02.2013; Diplomën me numër 54-P/09 të datës 17.12.2009; Diplomën universitare të datës 17.04.2009; Certifikatën lidhur me pjesëmarrjen në trajnimin "Menaxhimi i Kohës dhe Delegimi i Përgjegjësive"; Certifikatën lidhur me pjesëmarrjen e trajnimit " Ligjin për Procedurën e Përgjithshëm Administrative" të mbajtur me 20-21.09.20218; Certifikatën lidhur me pjesëmarrjen e trajnimit "Menaxhimi i Kualitetit në Shërbime Publike"; Certifikatën lidhur me pjesëmarrjen në trajnimin "Përafrimi i Legjislacionit Vendore me Legjislacionin e Bashkimit Evropian"; Certifikatën lidhur me pjesëmarrjen e trajnimit "Menaxhimi i Burimeve Njerëzore" të mbajtur me datën 28029.03.2018; Certifikatën lidhur me pjesëmarrjen në trajnimin "Korniza e Përbashkët e Vete-Vlerësimi të datës 28-29.07.2015"; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit " The Ballkan Academy of Forensic Sciences" të mbajtur me datën 05-05.06.2011; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit "Përgatita e Raporteve" të mbajtur me 28-29.04.2022; Certifikatën e datës 15.09.2012 lidhur me përfundimin e kursit të gjuhës angleze; Aktin e emërimit nën shenjën AE.Nr.112/01-34463 të datës 10.11.2021; Ndryshim dhe plotësimin e aktit të emërimit me numër të protokollit 01-11262-2595 të datës 13.08.2018; Vendimin me numër 112102-34218 të datës 03.11.2021; të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës; Vendimin me numër 112/02-559 të datës 15.01.2018; Vërtetimin e marrëdhënies së punës 112/184/2022 të 24.08.2022; Vërtetimin me numër 370/14 të datës 22.07.2014; Vërtetimin me numër 124/12 të datës 07.09.2012; Akt emërimit me numër të protokollit 112-14312 të datës 10.09.2013; Vendimin me numër 1409/15 të datës 22.04.2015; Vërtetimin marrëdhënies së punës me numër 112/184/2022 të datës 24.08.2022; Letër rekomandimin e lëshuar nga Drejtorit i Drejtorisë për Punë; Diplomën e datës 16.03.2001; Letër Rekomandimin e lëshuar nga Kryetari i Komunës së Gjakovës, mars-2018; Letër rekomandimin e lëshuar nga Drejtoresha e Drejtorisë për Pune Inspektuese; Referencën e lëshuar nga Drejtori i Drejtorisë për Punë Inspektuese; Referencën e lëshuar nga Nënkryetari i Komunës së Gjakovës , dhjetor-2021; kopje e ID-së; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2022; Vërtetimin me numër 112/182/2022 të datës 24.08.2022 të lëshuar nga Zyrtari i Lartë i Burimeve Njerëzore; Certifikatën nën shenjën PN.Nr.7706/2022 të datës 23.08.2022; Aplikacionin e datës 09.09.2022 të kandidatit së bashku me dokumentacionin percjelles; Vendimin me numër të protokollit 5679-03 të datës 20.09.2022 të Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë, Ndermarresiesë dhe Tregtisë " Internacional; Diplomën me numër 75 të datës 05.07.2022; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit "Internacional Corrections Management Training Center" të mbajtur me 22.04.2022; Shkresën (pa numër dhe datë) të lëshuar nga drejtoresha e Europian Resuscitation Council; Ceretifikaten lidhur me përfundimin e trajnimit "Horizontal Facility the Eastern Ballkans and Turkey-2019-2022; mirënjohjen e lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës; Certifikatën me numër 2063 të datës 15.11.2021 Zëvendës Drejtorit



të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës; Certifikatën nën shenjë 2063 të datës 08.12.2021 të lëshuar nga Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës; Certifikatën lidhur me përfundimin me sukses të kursit "Basic Life Support Instructor"; Certifikatën e datës 27.01.2020 -31.02.2020 të lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës; Mirënjohjen për rezultatet e arritura në vitin 2019 në Shërbimin Korrektues të Kosovës të lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm në SHKK; Mirënjohjen e detyrës 31.12.2018 për kontributin dhe përkushtimin e treguar gjatë punës në S.S.L të lëshuar nga Drejtori i Institucionit Ministria e Drejtësisë; Certifikatën të datës 12.08-25.10.2013 të lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës; Certifikatën e datës 25-29.10.2021; Kontratën e punës (pa datë dhe numër) për kohë të pacaktuar; Vendimin me numër 0448 të datës 25.02.2021 lidhur me ri-themelimin e Komisionit të Vlerësimit në Shërbimin Korrektues të Kosovës; Vendimin me numër të protokollit 0668 të datës 18.05.2021 lidhur me themelimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave Ri-tenderin në Shërbimin Korrektues të Kosovës; Vendimin me numër protokollit 0679 të datës 21.05.2021 lidhur me themelimin e komisionit për vlerësimin e ofertave me titullin "Mirëmbajtja , servisimi dhe instalimi i sistemit të kamerave në Institucione Korrektuese"; Vendimin me numër të protokollit 0865 të datës 21.07.2021 lidhur me themelimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave të tenderit ....; Vendimin me numër të protokollit 0946 të datës 23.08.2021 lidhur me themelimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave kuatimi dhe çmimi; Vendimin me numër Nr.0054 të datës 19.01.2022 lidhur me themelimin e Komisionit për hartimin e specifikave " Instalimi i sistemit të kamerave në Q.P Pejë dhe Q.K.F Lipjan; Vendimin me numër 0054 të datës 19.01.2022 për ndryshim dhe plotësimin e Vendimit me numër të protokollit 0054 të datës 19.01.2022 të lëshuar nga Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës; Vendimin me numër 0201 të datës 18.02.2022 të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës;kopje e ID-së; Formularin e vlerësimeve të rezultateve në punë për vitin 2022; Formularin e vlerësimeve të rezultateve në punë për vitin 2020; Vërtetimin e datës 13.05.2022, të lëshuar nga Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Juridike dhe Punë të Përgjithshëm; Vendimin me numër Ref.02/Nr.298 të datës 20.09.2022 të lëshuar nga Zv.Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Industrisë dhe Ndërmarrëses; Emalin e datës 21.09.2022 të drejtuar Emalin e datës 21.09.2022 të drejtuar Emalin e datës 21.09.2021 të drejtuar Formularët e Vlerësimit të datës 30.01.2023; Vendimin me numër të protokollit 534/2023 të datës 19.01.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Renditja përfundimtare e kandidateve e datës 30.01.2023; Raportin për përfundimin e procedurës Lëvizje Brenda Kategorisë pa kandidate fitues për pozitën e punës "Udhëheqës i Sektorit për Sigurinë e Produkteve"; Vendimin me numër të protokollit 493-3 të datës 31.01.2023 të lëshuar nga Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrëses dhe Tregtisë; Njoftimin e datës 31.01.2023 të Njesisë së Burimeve Njerëzore; Emalin e datës 31.01.2023 të ZKP drejtuar Emalin e datës 31.01.2023 të drejtuar ZKP; Emalin e datës 31.01.2023 të ka drejtuar Emalin e datës 01.02.2023 të drejtuar ; Emalin e datës 08.02.2023 të drejtuar ; Përgjigjen me numër 583-18 të datës 07.02.2023; Vendimin me numër të protokollit 660-19 të datës 10.02.2023 të kryesueses së Komisionit Vlerësues;

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit, *sepse:*



Nga administrimi i provave materiale rezulton së Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë më datë 19.08.2022 ka publikuar Konkursin me numër reference RN00009710 për lëvizje brenda kategorisë, për pozitën e punës "*Udhëheqës i Sektorit për Sigurinë e Produkteve*", e në të cilin konkurs ka aplikuar dhe ankuesi. Rrjedhimisht, konkursi në fjalë ka qenë i hapur për aplikim nga data 07.09.2022 deri më datë 14.09.2022 dhe së në këtë konkurs kanë aplikuar tre kandidatë, ku vetëm dy prej tyre (përshirë ankuesin) kanë plotësuar kriteret e konkursit. Konkursi ka vazhduar me intervistën me gojë e cila është mbajtur me datë 30.09.2022 dhe së ankuesi ishte i vetmi kandidat pjesëmarrës në intervistë.

Duke qenë së ankuesi nuk ishte njoftuar lidhur me rezultatin e intervistës me gojë, i njëjti më datë 31.10.2022 i është drejtuar më shkrim Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, më kërkesë që të njoftohet lidhur më rezultatin e intervistës me gojë, ndërsa më datë 14.11.2022 Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore ka njoftuar ankuesin se : *kërkesa juaj është adresuar tek Kryesuesja e Komisionit pasi që çështja ka mbetur tek Kryesuesja e Komisionit për përfundimin e procesit.*

Ankuesi me datë 21.11.2022 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të mos publikimit të vlerësimit të rezultateve të intervistës me gojë lidhur me Konkursin për lëvizje brenda kategorisë, për pozitën e punës Udhëheqës i Sektorit për Sigurinë e Produkteve, në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa Këshilli me Vendimin A.nr.1033/2022 të 19.01.2023 ka aprovuar ankesën e ankuesit si të bazuar dhe ka obliguar Komisionin e Vlerësimit që në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të përfundoj procesin e vlerësimit lidhur me pozitën e punës Udhëheqës i Sektorit për Sigurinë e Produkteve.

Në zbatim të vendimit të Këshillit, Komisioni i Vlerësimit ka përfunduar procesin e vlerësimit lidhur me ankuesin, me ç'rast i njëjti ka arritur të vlerësohet me gjithsej pesëdhjetetë (58) pikë. Tutje, me datë 31.01.2023, Njësia e Burimeve Njerëzore ka shpallur njoftimin për përfundimin e procedurës për lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës *Udhëheqës i Sektorit për Sigurinë e Produkteve*, pa kandidat fitues.

Ankuesi i pakënaqur me rezultatin e vlerësimit, ka ushtruar ankesë të brendshme të Komisioni Vlerësues, i cili me Vendimin me numër protokoll 660-19 të datës 10.02.2023 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të papabazuar.

Brenda afatit ligjor ankuesi parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës duke kundërshtuar Vendimin me numër protokoll 660-19 të datës 10.02.2023 të Komisionit të Vlerësimit, me pretendim ankimor se formularët e vlerësimit janë plotësuar nga i njëjti person dhe në forme të parregullt. Propozon që Këshilli të anuloj në tërësi procedurën e rekrutimit për lëvizjen brenda kategorisë për pozitën e punës *Udhëheqësi Sektorit për Sigurinë e Produkteve*.

Sipas Konkursit më numër reference RN00009710 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës "*Udhëheqës i Sektorit për Sigurinë e Produkteve*", si kushte për lëvizjen brenda kategorisë janë përcaktuar: *Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon; Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende; Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit'. Ndërsa, si kërkesat e përgjithshme formale janë vendosur: Arsimimi i kërkuar: Diplomë e studimeve universitare, Fakulteti Ekonomik, Juridik, Teknik me të paktën 240 kredi apo ekuivalente me to; Përvoja e punës e kërkuar: së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale.*



Në kuptim të shqyrtimit të bazushmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat ligjore lidhur me procedurën e lëvizjes brenda kategorisë, përkatësisht:

**Ligjin Nr.06/L-114 për Zyratë Publikë-Neni 38** me të cilin është përcaktuar se: "1. Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë. 2. Nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në kuadër të Shërbimit Civil, që i plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e posaçme për vendin e lirë, mund të aplikojnë për plotësimin e një vendi të lirë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes, sipas paragrafit 1 të këtij neni....5. Vlerësimi i kandidatëve të interesuar kryhet nga një komision vlerësimi, i krijuar në çdo institucion, bazuar në një intervistë me kandidatët. Komision përbëhet nga pesë anëtarë, njëri nga të cilët është domosdo përfaqësues i Njësisë së Burimeve Njerëzore të institucionit. 6. Në përfundim të vlerësimit, Komisioni mund të vendosë: 6.1. përzgjedhjen e kandidatit më të suksesshëm për t'u emëruar në vendin e lirë, apo; 6.2. përfundimin e procedurës, pa asnjë të përzgjedhur, në rast se asnjë nga kandidatët e interesuar nuk vlerësohet i suksesshëm për atë vend të lirë të punës."

**Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës - Neni 41** ka përcaktuar se: 1. Për të aplikuar për lëvizjen brenda kategorisë, duhet të plotësohen së bashku, kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën zhvillohet procedura e konkurimit. 2. Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për procedurë të lëvizjes brenda kategorisë janë: 2.1. të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon; 2.2. të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale; 2.3. të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende; 2.4. të jetë vlerësuar të paktën "mirë" për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit. 2.5. Në rastin e konkurrimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit. Neni 44 më të cilin është përcaktuar se: "1.Konkurimi për lëvizjen brenda kategorisë zhvillohet në dy faza: 1.1. verifikimi paraprak i kandidatëve; dhe 1.2. vlerësimi i kandidatëve. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ, ndërsa vlerësimi i kandidateve kryhet nga Komisioni i Vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë, krijuar sipas nenit 47 të kësaj Rregulloreje...". Neni 45 më të cilin është përcaktuar se: "1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurohet. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ. 3.Në përfundim të verifikimit paraprak NJBNJ përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lire. Vetëm këta kandidatë kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin". Neni 47 përcakton se: "1.KVLBK zhvillon një intervistë me gojë me kandidatët. 2.Nëpërmjet intervistës, KVLBK vlerëson jetëshkrimin/CV, njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për pozitën e punës për të cilën zhvillohet konkurimi. 3.KVLBK përgatit përpara fillimit të intervistës një grup pyetjesh. Intervista që zhvillohet është e strukturuar dhe me pyetje të njëjta për të gjithë kandidatët e cila përgatitet në ditën e zhvillimit të intervistës.. 4.Vlerësimi maksimal në intervistën me gojë është njëqind (100) pike". Neni 48 me të cilin përcaktohet se: "...Pikët e çdo anëtari për çdo vlerësim mbledhen dhe pjesëtohen me pesë. 2.Në përfundim të fazës të vlerësimit, pikët e përfituara nga secili kandidat në secilën nga hapat e vlerësimit, mbledhen dhe shuma e pikëve për të gjithë hapat e vlerësimit përbën vlerësimin përfundimtar të konkurrimit...". Neni 49 me të cilin përcaktohet se: "1.KVLB në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, harton dhe miraton një listë me vlerësimet përfundimtare të të gjithë kandidatëve. Kandidatët renditen në listë sipas rezultatit të vlerësimit përfundimtar në rendin zbritës. Lista i dërgohet Njësisë Përgjegjëse brenda njëzetë e katër (24) orëve nga miratimi i saj. 2.Kandidati që është vlerësuar me më shumë pikë dhe që ka marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë është kandidati fitues dhe ka të drejtën të emërohet në pozitën e lirë për të cilën është zhvilluar konkurimi. 3.Nëse asnjë nga kandidatët nuk është vlerësuar me gjashtëdhjetë 60 e më shumë pikë, procedura e lëvizjes brenda kategorisë përfundon pa kandidat fitues..".

Ndërlidhur me pretendimin ankimor së formularët e vlerësimit janë plotësuar në mënyrë të parregullt, Kolegji në vështrim të dispozitave të nenit 47 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK)



Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku thuhet se: KVLBK zhvillon një intervistë me gojë me kandidatët. 2.Nëpërmjet intervistës, KVLBK vlerëson jetëshkrimin/CV, njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për pozitën e punës për të cilën zhvillohet konkurrimi, ka konstatuar se vlerësimi i kandidateve nëpërmjet intervistës të procedura e lëvizjes brenda kategorisë është vlerësim gjithëpërfshirës, duke nënkuptuar vlerësimin e përbashkët të jetëshkrimit, aftësive dhe njohurive për pozitën përkatëse, andaj në vlerësimin e Kolegjit pretendimi ankimor mbi këtë bazë kundërshtimi nuk ka mbështetje ligjore.

Referuar pretendimit ankimor se formularët individual të vlerësimit janë plotësuar nga i njëjti person, Kolegji i Këshillit bazuar në provat materiale të çështjes nuk ka arritur të vërtetoj një pretendim të tillë, pasi që formularët e vlerësimit vërehet se janë nënshkruar individualisht nga secili anëtar veç e veç.

Duke u nisur nga fakti se ankuesi është vlerësuar me gjithsej pesëdhjetetë (58) pikë të vlerësimit, atëherë në kuptim të nenit 49 paragrafi 2 të Rregullores(QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, numri i pikëve të vlerësimit të ankuesit janë të pamjaftueshme që i njëjti të konsiderohet kandidat i suksesshëm, kështu që mbi këtë bazë rrjedhë së Komisioni i Vlerësimit me të drejtë dhe në pajtim me nenin 47 paragrafi 3 të kësaj rregullore ka përfunduar procedurën për lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës *Udhëheqës i Sektorit për Sigurinë e Produkteve* pa kandidat fitues.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit në mbështetje të dispozitave të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

*Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.485/2023

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në MINT-së; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.